



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.480/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Halil Shala votues nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.480/2019. i datës 08.11.2019, parashtruar nga Halil Shala, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Suzana Muriqi, në të cilin parashtruesja e apelit pretendon se në vendvotimin me nr. 1723C-03R në Pejë, ishte votuar nga Halil Shala dhe nga anëtarët e familjes së tij, dhe se dyshon që këto vota iu janë bartur një kandidati tjetër. Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të pretendimeve në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj lejueshmërinë e apelim, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Suzana Muriqi, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është i palejuar, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standardet e kërkuara sipas nenit 10 par.7 dhe nenit 5 par.7 të Rregullës Nr.02/2015, sepse ankesa është parashtruar nga personi i paautorizuar,, gjegjësisht votuesi e jo nga kandidatja për deputete.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Anr. 480/2019 më datën 09.11.2019

Kryesues i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.